

Informacion për pacientët mbi Covid-19

Mjekët e infektivit dhe fleta e tyre, për mbrojtje nga infeksionet.

Pse e kam marrë këtë informacion?

Testet kanë zbuluar se jeni infektuar me COVID-19, i cili është shkaktuar nga coronavirusi SARS CoV-2.

Çfarë është Covid-19?

Covid-19 është një infektion virusi, i cili shpesh jep simptoma të lehta, si rrufë, dhembje të fytit, kollë dhe ethe, por një pjesë sëmurën më rëndë, me shqetësime në frymëmarrje dhe ata kanë nevojë të mjekohen në spital. Simptoma të tjera të Covid-19, mund të jenë dhembje të muskujve, dhembje të kokës, lodhje, keqësim i shqisave të nuhatjes dhe të shijuarit, si dhe shqetësim në bark, me diarre.

Si infekton Covid-19?

Covid-19 transmetohet kryesisht përmes kontakteve të ngushta përmes spërklave nga rrugët e frymëmarrjes. Kur person i infektuar teshtin, kollitet, flet ose nxjerr frymë, spërklat shpërndahet në ambient. Infeksioni hyn në trup si përmes frymëmarrjes ashtu edhe prekjes së syve dhe membranës së mukozës në hundë dhe gojë me duar të papastra.

Një person i infektuar mund të infektojë të tjerët edhe para shfaqjes së simptomave. Koha e infeksionit deri në sëmundje (periudha e inkubacionit), është nga 2 deri në 14 ditë, por zakonisht ndodh nga 3 deri në 4 ditë.

Për sa kohë jam infektues?

Periudha gjatë së cilës jeni infektues mund të ndryshojë nga njërit te tjetri. Ata që janë të sëmurë rëndë janë zakonisht infektues pak më gjatë, në krahasim me ata që janë sëmurë lehtë.

- Ju konsideroheni person infektues për të paktën 5 ditë nga dita e shfaqjes së simptomave. Nëse nuk jeni përmirësuar në përgjithësi dhe keni pasur temperaturë gjatë dy ditëve të fundit, atëherë ju mund të jeni infektues për pak më shumë se 5 ditë. Nëse edhe pas 5 ditësh keni simptoma të lehta si kollë e thatë dhe humbje të nuhatjes dhe shijes, atëherë nuk jeni më infektues. Nëse keni bërë testin edhe pa pasur simptoma, 5 ditët fillojnë nga dita e bërjes së testit.
- Në rastin e mësipërm, përjashtimi ndodh nëse **jeni punonjës i kujdesit shëndetësor dhe nuk i keni marrë të paktën 3 doza**, atëherë konsideroheni person infektues për të paktën 7 ditë nga dita që u sëmurët. Nëse keni bërë testin edhe pas pasur simptoma, 7 ditët fillojnë nga dita e bërjes së testit.
- Nëse **jetoni në një qendër të veçantë strehimi për të moshuarit ose keni qenë i shtruar në spital**, mjeku juaj mund t'ju informojë se për sa kohë mund të jeni infektues. Kjo vlen edhe nëse keni imunodeficiencë të rëndë.

Çfarë duhet të bëj për të mbrojtur të tjerët nga infeksioni?

- Ju këshillojmë që të qëndroni në shtëpi dhe të shmangni kontaktet e afërta me të tjerët, për aq kohë sa jeni infektues.
- Nëse jeni punonjës i kujdesit shëndetësor, atëherë ju këshillojmë që të vini në dijeni punëdhënësin tuaj.

Gjurmimi i rasteve të infektuara: Çfarë do të thotë?

Gjurmimi i rasteve të infektuara duhet të bëhet në mjediset e kujdesit shëndetësor ku janë njerëzit që rrezikojnë të sëmurën rëndë me Covid-19. Prandaj, është e detyrueshme të jeni

pjesë e masave në fuqi të gjurmimit të rasteve të infektuara për të gjetur dhe informuar ata që mund të jenë ekspozuar ndaj infeksionit në mjediset e kujdesit shëndetësor.

Si duhet të veprojmë, nëse unë kam nevojë për mjekim për Covid-19, ose për ndonjë sëmundje tjetër?

- Nëse keni nevojë për këshilla mjekësore telefononi në numrin 1177. Ju do të merrni ndihmë për të vlerësuar simptomat ose se ku mund të kërkontë kujdes mjekësor.
- Nëse keni nevojë për kujdes mjekësor, atëherë është e rëndësishme që së pari të telefononi dhe të mos shkoni menjëherë te klinika e mjekut të përgjithshëm. Kjo bëhet për të mos infektuar të tjerët në klinikë. Kur të telefononi, do të udhëzoheni se çfarë duhet të bëni.
- Nëse gjendja juaj shëndetësore kthehet në rrezik për jetën, atëherë telefononi në nr. 112.